REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 280/20
Datë/Datum. 07.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **656-17-3827-5-1-1**

Sa i përket tenderit për:

Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Konzorciumi:
KNPSH"PAPENBURG&ADRIANI COMPANY Sh.p.k.&Companya ESKAVATORI Sh.p.k. & Best Company Sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sojevë-Ferizaj
(Adresa)

Ferizaj/Kosovë — 70 000
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 44 503 418 — /
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Muhamet Dervishi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

papenburg_adriani@yahoo.com
(Adresa elektronike)

07.05.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

PAPENBURG+ADRIANI COMPANY" SH.P.K. SOJEVË FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____/_____
(Emri i avokatit)

_____/_____
(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____
(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar, Nr. I prokurimit: 656-17-3827-5-1-1, Nr. I brendshëm: 656-17-115-511 Njoftimi për kontratë është publikuar në platformen elektronike e-prokurimi.rks-gov.net më datë: 18.08.2017 Më datë 24.04.2020 përmes e-prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letren standarde për tenderuesin e pasuksesshëm. Afati i fundit për dorëzim ka qenë: 26.09.2017 ora 14:00:00 Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] Jo [ ]

Po kemi marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve, procesi i hapjes ka rrjedhë normalisht.

PAPENBURG+ADRIANI COMPANY SH.P.K. PRISHTINË

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] ***Jo*** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Më datë 24.04.2020 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues Komuna Ferizaj në lidhje me njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues për aktivitetit të prokurimit me titull : Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar, nr. të prokurimit: 656-17-3827-5-1-1

Më datë 28.04.2020 kemi pranuar përmes e-prokurimit përgjigjen e AK Komuna Ferizaj, ku refuzohet kërkesa për rishqyrtim duke u cilësuar si e pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues Komuna Ferizaj ka shkelura dispozitat LPP përkatësisht:
Neni 13: Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
Neni 7: Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

KOMPANIA "PAPENBURG+ADRIANI COMPANY" SH.P.K SOJEVE * FERIZAJ *

8. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

ANKESË

Aktiviteti i Prokurimit:
Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar
Nr. I Prokurimit: 656-17-3827-5-1-1
Nr. I Brendshëm: 656-17-115-511
Në lidhje me Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 24.04.2020 dhe letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm të datës 24.04.2020.

Më datë 24.04.2020 kompania jonë përmes platformës elektronike të prokurimit ka pranuar Njoftimin Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me projektin në fjalë, ku në këtë njoftim AK Komuna Ferizaj shpërblen me kontratë OE Gerlica Company. Po ashtu më 24.04.2020 kemi pranuar letren stadarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Me date 17.10.2019 AK Komuna Ferizaj kishte shpallur fitues për këtë projekt OE Gerlica Company, kunder ketij vendimi konzorciumi jonë me të drejtë ligjore më 06.11.2019 kishte parashtruar ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Pas shqyrtimit të ankesës sonë nga OSHP më datë 23.12.2019 kemi pranuar vendimin e panelit shqyrtues me numër 778/19 per ankesen e parashtruar. Në këtë vendim ankesa jonë aprovohet si e BAZUAR dhe anulohet vendimi në fjalë dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM.

Duke u bazuar në vendimin e OSHP të ankeses me numer 778/19 është e pakjartë se si është e mundur që edhe pas kthimit në rivlerësim nga OSHP AK Komuna Ferizaj prap padrejtësisht shpall fitues një operator ekonomik i cili nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit në fjalë dhe është i pa përgjegjshëm kjo vërtetohet edhe ne raportin e ekspertit shqyrtues ku ceket se dokumentet-diploma e dorëzuar nga OE i shpallur fitues është në kundërshtim me LPP-në.

OE i shpallur fitues nuk plotëson kërkesat mbi mundësite teknike dhe/ose profesionale pasi që për kërkesën për gjeodetin e licensuar ka ofruar diplomën universitare në gjuhë Maqedone, të z. Zekirja Elezi, e cila bie në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të ligjit të prokurimit publik në fuqi, ku shume kjart definohet se dokumentet tenderuese duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe, Serbe ose Angleze.

Po ashtu diploma për gjeodetin është diplomë universitare e fituar jashtë shtetit të Kosovës por për diplomën në fjalë mungon nostrifikimi i diplomës dhe si e tillë, pa nostrifikim, ajo është e pa vlefshme.

Me favorizimin e OE fitues duke e shperblyer me kontratë edhe pse nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë shkelet neni 7 i ligjit të prokurimit publik në fuqi.

Po ashtu vlen të theksohet se AK në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues shpall fitues OE Gerlica Company por pas qasjes në dokumentacionin tenderues kemi vërejtur se kompania konkuron në konzorcium me kompaninë KAG Aspahlt Company, e cila nuk figuron fare ne njoftimin mbi vendimin e AK.

Si pasojë e shkeljeve të lartëpërmendura konzorciumi jonë propozon që:

TË APROVOHET si e bazuar ankesa jonë kundër vendimit të datës 24.04.2020.
Dhe të ANULOHET vendimi i datës 24.04.2020 të tenderit: Asfaltimi i rruges Pleshine-Kashtanjeve te Ferizajt-projekt tre vjeqar me nr. Të prokurimit: 656-17-3827-5-1-1dhe lënda të kthehet në RIVLERSIM.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë se shkeljet e cekura më lartë kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme materiale, kjo nga shkaku se kemi humbje materiale lidhur me kostot që kanë të bëjnë me përgatitjen e ofertave. Kemi poashtu humbje të konsiderueshme edhe sa i përket taksave të cilat jemi obliguar që t'i paguajmë për të siguruar garancionin bankar për sigurimin e tenderit në të gjitha rastet e tenderimit të kësaj kontrate si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e ankesave.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*